

Më
Dana 22.06.2018

P.nr.263/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me sekretaren juridike Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] me vendbanim Ferizaj, rruga [REDAKTUAR], i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2014-2/17 të dt. 08.02.2018, sipas së cilës e ka kryer veprën penale "posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.23.05.2018 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2014-2/17 të dt.08.02.2018, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] me vendbanim Ferizaj rruga [REDAKTUAR], ku edhe tani jeton, i lindur me datë, [REDAKTUAR], ne [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, me gjendje mesatare ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 22.06.2017, rreth orës 22:20, ne Ferizaj, ne rrugën "Ali Hadri", gjate kontrollimit nga ana e Njesise Patrulluese te Stacionit Policor ne Ferizaj, kishin ndalur nje veture, ne te cilën kishin qene tre persona, ku te i pandehuri kane gjetur dy cigare ne substance narkotike te llojit marihuan ne peshe 1.70 gram, - te cilën substancën narkotike policia e kane sekuestruar,-

- me të cilën kreu veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 100 € (njëqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2014-2/17 të dt.08.02.2018 ka akuzuar [REDAKTUAR] me vendbanim në Ferizaj, rruga [REDAKTUAR] për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht në deklaratën e te pandehurit të datës 22.06.2017 dhe në polici, vërtetimin mbi konfiskimin të përkohshëm të gjësendeve të datës 22.06.2017, si dhe në fotot që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konformë nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.263/18 i dt.23.05.2018

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtë, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.